“Drejtoni rreshtat, sepse drejtimi i rreshtave është pjesë e plotësimit të namazit!

Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Drejtoni rreshtat, sepse drejtimi i rreshtave është pjesë e plotësimit të namazit!"
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti në këtë hadith i urdhëron namazlijtë të drejtojnë rreshtat dhe të mos dalin përpara e as mbrapa njëri-tjetrit. Drejtimi i tyre e kompleton dhe e përsos namazin, ndërsa shtrembërimi i tyre është parregullsi dhe mangësi në të.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3031